

PËRPARËSITË DHE PRIVILEGJET E “KARTËS EXTRA”

Kushtet e përdorimit të Kartës Extra:

1. Të gjithë personave mbi 18 vjeç, që janë resident pajisen me një Kartë Extra të personalizuar. Karta Extra është një kartë klienti e cila mundëson regjistrimin e veprimeve në sistem dhe në llogarinë individuale të kartëmbajtësit.

2. Karta Extra është në pronësi të Nexuscom Ballkan, pjesë e Çelesi Media Group. Nëse karta përdoret për qëllime të tjera nga ajo që është parashikuar, Nexuscom Ballkan i lind e drejta të pezullojë përdorimin e kartës pa njoftim paraprak. Karta është individuale dhe nuk ka afat skadence, vetëm nëse përcaktohet ndryshe nga Nexuscom Ballkan.

3. Në rast humbje, vjedhje ose dëmtimi të kartës, përdoruesi duhet në mënyrë të menjëheshme të bëjë komunikimin tek shërbimi ndaj klientit i Kartës Extra në numrin 04 2268 104 dhe në adresën e email-it info@kartaextra.com, duke e pasuar më pas me një komunikim me shkrim drejtuar Nexuscom Ballkan me seli ne: Rr. “E Kavajës”, Qendra Condor, kati i 3. Blllokimi i kartës do bëhet i mundur brënda 24 orëve nga momenti i njoftimit. Pikët e grumbulluara do të transferohen në kartën e re. Nëse pikët e ndodhura në kartë janë përdorur përpara se të bëhet bllokimi i kartës, ato nuk mund të kompesohen më në një kartë të re.

Kërkesa për aktivizimin e Kartës Extra presupozon pranimin e plotë të rregullores, e cila mund të shihet e plotë në zyrat e subjektit promovues ose në faqen www.kartaextra.com.

4. Karta do të lëshohet nga personeli i pikave të shitjes pjesë e rrjetit, të dallueshme nga një shenjë identifikimi në formën e një adevizi të ngjitur në vitrinën e biznesit, pas plotësimit të formularit të antarësimit nga ana e përdoruesit. Nënshkrimi i këtij formulari nënkupton pranimin e plotë të kësaj rregulloreje. Nexuscom Ballkan është i angazhuar për përdorimin dhe mbajtjen e informacionit të lëshuar në formularin e aplikimit në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar mbi trajtimin dhe përpunimin e të dhënave personale sipas dispozitave referuar ligjit nr. 9887, dt. 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

5. Politika e avantazheve, bonuseve dhe skontove që pjestarët e rrjetit Karta Extra aplikojnë për kartëmbajtësit mund të jetë i ndryshëm nga një subjekt tregtar tek tjetri. Nexcom Ballkan i mundëson çdo kartëmbajtësi transparencën e plotë për politikën e secilit subjekt nëpërmjet faqes www.kartaextra.com dhe komunikimeve të ndryshme.

6. **Produktet që janë pjesë e promovimit:** Të gjitha produktet dhe shërbimet e ofruara gjatë fushatës promovuese duhet të jenë të evidentuara në të gjitha dyqanet pjesë e rrjetit Karta Extra. Dyqanet që janë pjesë e fushatave promovuese i gjeni në faqen www.kartaextra.com.

7. **Pjesëmarrësit në Promocion:** Pavarësisht se në cilin subjekt një konsumator pajiset me Kartën Extra, kjo kartë njihet, pranohet dhe shpërblehet me ulje apo bonuse të tjera nga i gjithë rrjeti i subjekteve pjesë e Kartës Extra sipas politikave të uljeve, bonuseve dhe promovimeve që secili prej subjekteve ndërmerr dhe aplikon.

8. **Funksionimi i Kartës Extra dhe sistemi i pikëve:** Koncepti bazë mbi të cilin funksionon Karta Extra është ai i ofrimit të uljeve apo skontove të ofruara për çdo blerje në formë pikësh të ngarkuara në llogarinë e çdo kartëmbajtësi. Në bazë të politikave të uljeve, bonuseve dhe promovimeve që secili prej subjekteve ndërmerr dhe aplikon, klientët kartëmbajtës grumbullojnë pikë në çdo blerje në të gjithë rrjetin Karta Extra. Pikët e grumbulluara në kartën e lidhur me llogarinë e tyre personale mund të përdoren gjithashtu si vlerë monetare në të gjitha subjektet pjesë e rrjetit Karta Extra për të realizuar me to blerje të çfarëdo malli apo shërbimi që kartëmbajtësi zgjedh. Qoftë për të grumbulluar pikë, qoftë për të realizuar blerje nëpërmjet pikëve të kartës, kartëmbajtësi duhet të ketë kartën me vete dhe ta paraqesë tek shitësi apo operatori i subjektit pjesëmarrës në rrjetin Karta Extra. Veprimet e ngarkimit, grumbullimit dhe shkarkimit të pikëve dhe vlera korresponduese monetare mund të kontrollohen në kuponin e poshtë të Kartës Extra ose duke aksesuar faqen www.kartaextra.com si dhe nëpërmjet aplikacionit Karta Extra e disponueshme për IOS dhe Android.

Gjatë promovimeve të veçanta dhe gjatë periudhës së shitjes akumulimi i pikëve mund të pësojë ndryshime, që do të bëhen të ditura për klientët e dyqaneve pjesëmarrëse përmes mjeteve të përshtatshme të komunikimit.

Përdorimi i pikëve të akumuluar është i mundur nga momenti i grumbullimit të një minimumi prej 500 pikësh dhe funksionon me shumëfishin e 500 pikëve. Pikët e grumbulluara mund të përdoren për të përfituar nga ofertat dhe zbritjet, sipas tabelës së mëposhtme:

PIKË	BONUS
500	500 lekë

Vlera e konvertimit të pikëve në kartë është 1 pikë = 1 lekë në momentin e zgjedhjes së një shërbimi apo produkti me pikët e kartës, pikët që korrespondojnë me shërbimin e zgjedhur do të zbriten nga pikët totale të kartës. Pikët e mbetura do të qëndrojnë në dispozicion të përdoruesit për të përfituar shërbime të tjera në vijim. Çdo përdorues mund të përdorë pikët e akumuluar për të përfituar skonto ose blerjen e një produkti çdo 500 pikë = 500 lekë, që të mund ti kërkojë stafit të rrjetit të dyqaneve Karta Extra produktet ose shërbimet e kërkuara. Vlerat e mbetura nën kufirin e 500 pikëve nuk mund të përdoren deri në momentin e plotësimit të këtij kufiri.

Dispozitat përfundimtare: Subjektit promovues i lind e drejta për të modifikuar në çdo kohë metodat e pjesëmarrjes duke mos paraqitur ndryshime rrënjësore dhe ruajtjen e të drejtave të fituara tashmë nga pjesëmarrësit. Kjo rregullore është në dispozicionin tuaj pranë zyrave qendrore të subjektit promovues.

9. Aplikacioni Karta Extra

Për të përfituar nga ofertat dhe shërbimet që Karta Extra ofron ju duhet të pajiseni me Kartën Extra, të cilën mund ta merrni lehtësisht në çdo dyqan pjesë të rrjetit Karta Extra ose përmes regjistrimit online në portalin www.kartaextra.com dhe përmes aplikacionit Karta Extra.

Duke klikuar mbi ikonën “Dyqanet”, ju do të njiheni me bizneset ku përfitoni ulje dhe oferta të dedikuara për ju në formë pikësh të ngarkuara në kartë nëpërmjet leximit të kartës nga sistemi që përdor secili prej këtyre bizneseve. Këto pikë të grumbulluara, çdo kartëmbajtës mund t’i përdorë si vlerë monetare për të realizuar çdo lloj blerje në të gjithë rrjetin e dyqaneve, pjesë e Kartës Extra.

Të gjitha veprimet (ngarkimin dhe përdorimin e pikëve), kartëmbajtësi mund t’i shohë në llogarinë e tij personale, duke klikuar tek ikona “Karta dhe të dhënat”.

Nëpërmjet ikonës “Oferta”, kartëmbajtësi njoftohet për uljet dhe ofertat e dedikuara që bizneset pjesë e Kartës Extra ofrojnë.

Nëpërmjet ikonës “Promocione”, kartëmbajtësi njoftohet për dyfishimin e pikëve, ofertat dhe promocionet që rrjeti Karta Extra ofron.

Nëpërmjet ikonës “Kupon”, kartëmbajtësi njoftohet për pajisjen me kupon promocional gjatë kryerjes së një transaksioni të veçantë.

10. Modifikimi i rregullores për rrjetin Karta Extra: Promovuesit i lind e drejta për integrimin ose modifikimin e Rregullores së paketës shpërblyese “Karta Extra”, duke u kujdesur që ndryshimet e bëra të mos dëmtojnë të drejtat e fituara nga pjesëmarrësit. Çdo ndryshim do t’u njoftohet pjesëmarrësve përmes komunikimeve në faqen www.kartaextra.com.

Promovuesi mund të pezullojë ose përfundojë aktivitetin vetëm për arsye madhore dhe në përputhje me Kodin Civil. Ndërprerja e programit përpara afatit (me pasojat përkatëse) do t’u komunikohet pjesëmarrësve të paktën 30 ditë përpara ose, duke iu referuar pezullimit, sa më parë që të jetë e mundur, ose nëse ndodh më vonë, menjëherë mbas kësaj. Një komunikim i tillë mund të kryhet nga promovuesi në faqen e web-it www.kartaextra.com, në pikat e shitjes tek Partnerët të cilët janë anëtarësuar në rrjetin Karta Extra.

NEXUSCOM BALLKAN

Rr. “Kavajës”, Tiranë

Condor Center, kati III-të

Tel: +355 04 2268 104

Cel: +355 68 20 98 246

E-mail: info@kartaextra.com/kartaextra@celesi.com

Web: www.kartaextra.com